

PROCESVERBAL

KONSULTIMI PUBLIK PËR PROJEKT PLANIN VENDOR TË SHËRBIMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2027–2029

Bashkia: SKRAPAR

Data: 16.07.2026

Ora: 10:00

Vendi: Salla e Keshillit Bashkiak, Skrapar

Hartimi i këtij Plani mbështetet në kuadrin ligjor kombëtar që rregullon organizimin e sistemit arsimor parauniversitar, kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore, mbrojtjen e fëmijëve dhe planifikimin financiar vendor. Në veçanti, ai bazohet në **Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar**, i cili përcakton përgjegjësitë e bashkive në ofrimin e shërbimeve publike vendore, mbështetjen e institucioneve arsimore dhe miratimin e dokumenteve strategjike vendore; **Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar**, që përcakton parimet dhe organizimin e arsimit parauniversitar; si dhe **Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar**, që garanton lidhjen e planifikimit strategjik me Programin Buxhetor Afatmesëm dhe buxhetet vjetore.

Të pranishëm:

Nën Prefekti

Përfaqësues të Institucioneve Vendore;

Drejtuesit dhe mësuesit e shkollave;

Përfaqësues të arsimit para-shkollor;

Përfaqësues të Bashkisë Skrapar;

Qytetar të qytetit të Çorovodës.

Objektivi i dëgjësës

Qëllimi i dëgjësës ishte diskutimi i **Draft Planit Vendor për Arsimit parauniversitar, Bashkia Skrapar**, me përfaqësues të institucioneve vendore, qytetarë si dhe dhënia e mendimeve, komenteve dhe sugjerimeve nga të gjithë aktorët e interesit.

Përmbledhja e diskutimeve

Prezantimi i Planit Vendor të Arsimit parauniversitar.

Takimi u hap nga Nën Kryetarja e Bashkisë Skrapar Znj. Sonila Hysenbelliu, e cila falënderoi pjesëmarrësit për praninë e tyre dhe theksoi rëndësinë e draft Planit Vendor të Arsimit parauniversitar për shkollat e qytetit dhe shkollat në varësi.

Më pas, Nënkryetarja shpjegoi rëndësin e Planit Vendor për Arsimit parauniversitar se aktualisht plani ka për qëllim, përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe kushteve didaktike nëpër kopshtet dhe shkollat e qytetit.

Ndër të tjera Bashkia tregoi mbështetjen dhe bashkpunim sa më të mirë me institucionet parauniversitare. mbështetje fuqizuese, përmirësim i aksesit si dhe targetim me efektiv.

Vizioni i këtij plani përqendrohet për një qëllim dhe një proces konsultiv sa më efektiv.

Plani është hartuar mbi bazën e analizës së të dhënave, kuadrit ligjor dhe nevojave konkrete të institucioneve arsimore, duke synuar përmirësimin e cilësisë së shërbimit, garantimin e aksesit të barabartë në arsim, rritjen e sigurisë dhe përmirësimin e kushteve infrastrukturore në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Skrapar.

Kontributi i secilit prej jush është i rëndësishëm për të siguruar që ky dokument të pasqyrojë nevojat reale të komunitetit dhe të shërbejë si një udhërrëfyes i zbatueshëm për zhvillimin e arsimit parauniversitar në vitet 2027–2029.

Të gjitha komentet dhe propozimet e paraqitura gjatë këtij konsultimi do të evidentohen në procesverbal dhe do të shqyrtohen gjatë finalizimit të planit.

Qëllimi i këtij plani është;

- Prezantimi i përmbajtjes kryesore të Planit Vendor të Shërbimit të Arsimit Parauniversitar 2027–2029.
- Evidentimi i gjendjes aktuale të arsimit parauniversitar në territorin e Bashkisë Skrapar
- Paraqitja e prioriteteve dhe objektivave strategjike për periudhën 2027–2029
- Mbledhja e mendimeve, sugjerimeve dhe komenteve nga të gjithë aktorët e interesuar për përmirësimin dhe finalizimin e planit

Zbatimi i suksesshëm i këtij plani do të përmirësoj zhvillimin sa më të mirë dhe efektiv nëpër shkollat dhe kopshtet e territorit tonë.

Pas përfundimit të prezantimit, Nën Kryetarja e Bashkisë ftoi të pranishmit, të shprehnin mendimet dhe rekomandimet e tyre lidhur me Planit Vendor të Arsimit parauniversitar..

Diskutimet, sugjerimet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve:

Gjatë zhvillimit të konsultimit publik për hartimin e Planit Vendor të Arsimit në Bashkinë Skrapar u zhvillua një diskutim i hapur dhe konstruktiv ndërmjet përfaqësuesve të institucioneve vendore, institucioneve arsimore, sektorit shëndetësor, prindërve dhe komunitetit. Takimi u karakterizua nga shkëmbimi i ideve, përvojave dhe praktikave të mira, si edhe nga paraqitja e propozimeve konkrete për përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe shërbimeve mbështetëse në territorin e bashkisë. Sugjerimet dhe rekomandimet e paraqitura synojnë të shërbejnë si elemente orientuese në hartimin dhe zbatimin e Planit Vendor të Arsimit.

Z. Astrit Mustafaj – Nënprefekt

Nënprefekti theksoi rëndësinë e garantimit të aksesit në arsim cilësor për të gjithë fëmijët, veçanërisht për nxënësit e moshës mbi 12 vjeç nga zonat rurale. Ai nënvizoi se kapacitetet akomoduese të Konviktit të qytetit janë të mjaftueshme për të përballuar një numër më të madh nxënësish, duke krijuar mundësinë që edhe nxënësit e arsimit 9-vjeçar të ndjekin shkollimin në qytet dhe të akomodohen në konvikt. Sipas tij, kjo do të kontribuonte në rritjen e cilësisë së arsimit, barazinë e mundësive dhe uljen e pabarazive ndërmjet nxënësve të zonave urbane dhe rurale.

Z. Dritan Myftari – Drejtor i Konviktit

Z. Dritan Myftari konfirmoi se Konvikti i qytetit disponon kapacitetet e nevojshme për të akomoduar të gjithë nxënësit që zgjedhin të ndjekin arsimin në shkollat e qytetit. Ai vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm me Bashkinë Skrapar, duke theksuar se ky bashkëpunim ka qenë dhe vijon të jetë mjaft frytdhënës në mbështetje të nxënësve nga zonat rurale që akomodohen në konvikt për të ndjekur arsimin e mesëm.

Në vijim, ai ngriti nevojën për rishikimin dhe rikonceptimin e ofertës arsimore në nivel vendor, me fokus zhvillimin e arsimit profesional. Sipas tij, mungesa e programeve të arsimit profesional në Bashkinë Skrapar bën që një numër i konsiderueshëm nxënësish, pas përfundimit të arsimit bazë, të vazhdojnë studimet në qytete të tjera, duke rritur kostot financiare për familjet dhe duke mos shfrytëzuar plotësisht kapacitetet ekzistuese të konviktit.

Duke iu përgjigjur pyetjeve të prindërve lidhur me sigurinë dhe kushtet e jetesës në konvikt, ai prezantoi organizimin e jetës së përditshme të nxënësve, duke sqaruar se standardet e sigurisë, mbikëqyrja, edukimi dhe shërbimi i ushqimit realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përfundim, ai ritheksoi nevojën për rishikimin dhe indeksimin e kuotës ditore të ushqimit për nxënësit e konviktit, duke argumentuar se niveli aktual është i pamjaftueshëm për të garantuar cilësinë dhe sasinë e nevojshme të ushqimit.

Dr. Armela Spahiu – Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Skrapar

Dr. Armela Spahiu evidentoi domosdoshmërinë e punësimit të një psikologu në sistemin parashkollor, me qëllim identifikimin e hershëm të fëmijëve me nevoja të veçanta ose aftësi ndryshe dhe ndërhyrjen profesionale në kohën e duhur.

Ajo theksoi gjithashtu rëndësinë e krijimit të një biblioteke funksionale të qytetit, si një instrument i rëndësishëm për nxitjen e leximit tek fëmijët dhe të rinjtë, promovimin e kulturës së librit dhe reduktimin e kohës së ekspozimit ndaj ekraneve dhe përdorimit të telefonave inteligjentë.

Z. Roland Caka – Drejtor i Gjinnazit "Ramiz Aranitasi"

Z. Roland Caka paraqiti situatën aktuale të Gjinnazit "Ramiz Aranitasi", duke theksuar se procesi mësimor zhvillohet në përputhje me standardet arsimore në fuqi dhe se institucioni karakterizohet nga një organizim i qëndrueshëm dhe një cilësi e mirë e mësimdhënies.

Ai evidentoi nevojën për investime në përmirësimin e rrethimit të shkollës, me synim rritjen e sigurisë së nxënësve, si dhe propozoi ngritjen e një laborator modern të informatikës, të pajisur me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për zhvillimin e mësimi praktik dhe forcimin e kompetencave digjitale të nxënësve.

Gjithashtu, ai theksoi rëndësinë e hartimit dhe zbatimit të projekteve sociale dhe edukative, të orientuara drejt rritjes së ndërgjegjësimit të nxënësve për vlerën e arsimit, promovimit të sjelljeve pozitive dhe të përgjegjshme, parandalimit të fenomeneve që ndikojnë negativisht në jetën shkollë, si dhe nxitjes së pjesëmarrjes aktive të tyre në aktivitete edukative, kulturore dhe komunitare.

Znj. Burbuqe Gëzhilli – Drejtoreshë shkolle 9-vjeçare "Kahreman Ylli"

Znj. Burbuqe Gëzhilli theksoi nevojën për përfundimin e rrethimit të plotë të shkollës që drejton, me qëllim garantimin e sigurisë së nxënësve gjatë pushimeve dhe kufizimin e daljes së tyre jashtë ambienteve shkollë për konsumimin e produkteve ushqimore jo të shëndetshme.

Ajo ngriti gjithashtu shqetësimin për situatën e dy familjeve në fshatin Vëseshtë, të cilat nuk pranojnë të dërgojnë fëmijët në ambientin mësimor të marrë me qira dhe të përshtatur nga Bashkia për zhvillimin e procesit mësimor, duke kërkuar ndërtimin e një godine të re shkollë.

Në këtë drejtim, u sugjerua një qasje më e strukturuar dhe bashkëpunuese me prindërit për të garantuar të drejtën e fëmijëve për arsim.

Znj. Renalda Hebibasi – Prind

Znj. Renalda Hebibasi ngriti shqetësime që lidhen me mirëqenien dhe sigurinë e fëmijëve. Në lidhje me akomodimin në Konviktin e qytetit, ajo kërkoi më shumë informacion mbi standardet e sigurisë, organizimin e jetës së përditshme, mbikëqyrjen dhe cilësinë e ushqimit të ofruar për nxënësit.

Gjithashtu, ajo evidentoi nevojën për zëvendësimin e pajisjeve hidrosanitare në shkollat 9-vjeçare me pajisje moderne dhe ergonomike, të përshtatura për moshën e fëmijëve, duke argumentuar se infrastruktura aktuale nuk garanton standardet e nevojshme të higjienës dhe aksesueshmërisë, veçanërisht për vajzat.

Përfaqësues të stafit të arsimit parashkollor

Përfaqësues të stafit edukativ të kopshteve evidentuan mungesën e mjeteve didaktike, duke theksuar se një pjesë e konsiderueshme e tyre sigurohen nga vetë edukatorët ose me mbështetjen e prindërve. U rekomandua rritja e investimeve për pajisjen e institucioneve

parashkollore me materiale didaktike të standardizuara dhe të përshtatshme për zhvillimin e fëmijëve.

Sugjerime dhe rekomandime të tjera të paraqitura gjatë konsultimit

Gjatë diskutimeve u propozuan edhe një sërë masash të tjera, të cilat u vlerësuan si të rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe mirëqenies së nxënësve, konkretisht:

Krijimi i një ambienti të dedikuar pranë shkollave të qytetit për konsumimin e ushqimit të sjellë nga shtëpia, me qëllim promovimin e ushqyerjes së shëndetshme, krijimin e kushteve të përshtatshme higjieno-sanitare dhe reduktimin e rasteve të bullizmit apo diferencimit social ndërmjet nxënësve.

Shqyrtimi i mundësive për kufizimin ose reduktimin e aksesit në internet përmes pajisjeve personale (smartphone) në ambientet shkollore, me synim rritjen e përqendrimit të nxënësve gjatë procesit mësimor, uljen e shpërqendrimeve dhe mbrojtjen e tyre nga ekspozimi ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme për moshën.

Në përfundim të konsultimit, pjesëmarrësit shprehën gatishmërinë për të vijuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe dialogun me komunitetin, duke vlerësuar se përfshirja aktive e të gjithë aktorëve është një element thelbësor për hartimin dhe zbatimin me sukses të Planit Vendor të Arsimit në Bashkinë Skrapar.

Bashkëngjitur: Lista e pjesëmarrësve në dëgjuesën publike dhe fotografi.

Mbajtësi i procesverbalit

Pergjegjëse e Arsimit

Ivi Dosti

